



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 Maj 2015
Nr. ref.: VHPK 796/15

VENDIM PËR HEDHJE POSHTË TË KËRKESËS

në

Rastin Nr. KI166/14

Parashtrues

Mentor Paqak

Kërkesë për rishqyrtim të lëndës KI78/14

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar,
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Z. Ibrahim Paqaku dorëzoi padi në Gjykatë, në emër të djalit të tij z. Mentor Paqaku nga Prizreni. Z. Ibrahim Paqaku gjithashtu përfaqësoi djalin e tij (atëherë parashtrues i kërkesës) në Rastin KI78/14.

Vendimi i kontestuar

2. Z. Ibrahim Paqaku nuk i referohet në mënyrë specifike ndonjë vendimi të Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, si duket parashtruesi kërkon rishqyrtimin e aktvendimit të nxjerrë në Rastin KI78/14.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për rishqyrtim të Rastit KI78/14.

Baza juridike

4. Letra e dorëzuar nga z. Ibrahim Paqaku është vazhdim i kërkesës KI78/14, e cila bazohej në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 47.1 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 10 nëntor 2014, z. Ibrahim Paqaku e dorëzoi kërkesën për rishqyrtim në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 5 dhjetor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI166/14 caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI166/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Artta Rama-Hajrizi.
7. Më 17 dhjetor 2014, Gjykata ia dërgoi parashtruesit të kërkesës formularin zyrtar të Gjykatës, duke kërkuar nga ai që të saktësojë se cili vendim dëshiron të rishqyrtohet dhe të dorëzojë dokumente shtesë për të mbështetur kërkesën e tij.
8. Më 16 prill 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 5 maj 2014, z. Ibrahim Paqaku, në emër të djalit të tij Mentor Paqaku, parashtroi në Gjykatë kërkesën KI78/14, duke kontestuar Vendimin e Gjykatës së Apelit, PN. nr. 637/2013, të 16 tetorit 2013, i cili i ishte dorëzuar atij në nëntor të vitit 2013.
10. Më 20 tetor 2014, Gjykata, deklaroi të papranueshme kërkesën KI78/14, sepse ishte parashtruar jashtë afatit ligjor.

Pretendimet e z. Ibrahim Paqaku

11. Z. Ibrahim Paqaku kërkon rishqyrtimin e rastit, pasi që djali i tij tani ka probleme shëndetësore.

12. Z. Ibrahim Paqaku thekson se “*tre avokat i kanë pasur në lënd gjdo dosje dhe raport mjekësor por pse nuk është cek në seancat gjyqësore nuk e di*”.
13. Z. Ibrahim Paqaku më tej thekson se “*ndoshta na cenohet e drejta si qenie njerzore vetëm e vetëm pse jemi minoritet*”.

Pranueshmëria e kërkesës

14. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 116.1 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, i cili parasheh:

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.

15. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 32 (5) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër (...) nëse kërkesa është përsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga Gjykata“.

16. Gjykata vëren se z. Ibrahim Paqaku thekson problemet shëndetësore të djalit të tij, si bazë për rishqyrtimin e vendimit të nxjerrë në Rastin KI78/14.
17. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se gjendja shëndetësore e djalit të tij nuk ndikon apo ndryshon rrethanat e kërkesës, e cila është parashtruar jashtë afatit ligjor, që ishte arsyeja për papranueshmëri.
18. Prandaj, Gjykata konstaton se vendimi i nxjerrë në Rastin KI78/14 është përfundimtar dhe detyrues dhe arsyeja e pretenduar për rishqyrtim është pa ndikim në vendimin e mëparshëm.
19. Si përmbledhje, në pajtim me nenin 116 të Kushtetutës dhe rregullin 32 (5) të Rregullores së punës, Gjykata refuzon kërkesën me procedurë të shkurtër, dhe për këtë arsye, ajo duhet të hiqet nga lista.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 116.1 të Kushtetutës dhe rregullin 32 (5) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 22 maj 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën me procedurë të shkurtër;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani